

VENDIM
Nr. 360, datë 24.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 170, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË
AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, 20 e 21 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e kreut IV të vendimit nr. 170, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Kapaciteti më i vogël i depozitave të shoqërive, që kërkojnë të pajisen me licencë tregtimi, sipas llojit të licencës, është:

a) Për licencat e tregtimit të llojit “A”, jo më pak se 500 (pesëqind) m³ dhe kur kjo licencë jepet për disa kategori produktesh, depozitat për secilën kategori duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra.

b) Për licencat e tregtimit të llojit “A”, kategoria IV/a, kapaciteti magazinues i mbuluar të jetë me sipërfaqe, jo më të vogël se 50 (pesëdhjetë) m².

c) Për licencat e tregtimit të llojit “B”, impiantet e depozitimit të gazit të lëngëzuar të jenë me kapacitet të instaluar, jo më pak se 100 (njëqind) m³.

ç) Për licencat e tregtimit të llojit “C”, kur:

i) licenca jepet për produkte të kategorisë II/b, jo më pak se 100 (njëqind) m³;

ii) licenca jepet për produkte të kategorisë III/c, jo më pak se 200 (dyqind) m³.

Bëjnë përjashtim nga kushti i plotësimit të kapacitetit më të vogël, sipas kësaj pike, shoqëritë anonime që kanë marrëdhënie kontraktore, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për depozitat e karburanteve në Portin e Durrësit. Kushti i kapacitetit më të vogël i depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse dhe i kalibrimit të tyre duhet të plotësohet brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve pas fillimit të zbatimit të masterplanit në territorin e depozitave të karburanteve në Portin e Durrësit.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha